



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 korrik 2014
Nr. ref.: RK682/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI88/14

Parashtrues

Medija Smailji

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Medija Smailji (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim të përhershëm në komunën e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, të cilin parashtruesja e kërkesës e ka pranuar më 7 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, *“i është mohuar e drejta për punë”*.
4. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të mos zbulohet identiteti i saj.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 maj 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI88/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI88/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 11 qershor 2014, Gjykata e informoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.
10. Më 2 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plot papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës, si mjeke specialiste e mjekësisë fizikale dhe e rehabilitimit, gjatë vitit 2001, me qëllim të zhvillimit profesional, e regjistroi subspecializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd.
12. Parashtruesja e kërkesës, nga punëdhënësi i saj, Shtëpia e Shëndetit në Prizren, kërkoi që të aprovojë mungesën nga puna për periudhën e zhvillimit profesional, por kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës ishte refuzuar.
13. Shtëpia e Shëndetit në Prizren, me Vendimin e Komisionit disiplinor, nr. 13/15, të 23 janarit 2001, largoi parashtruesen e kërkesës nga puna, ndërsa me Vendimin e drejtorit, nr. 3/61, të 27 nëntorit 2001, u refuzua kërkesa e parashtrueses për t'ia njohur të drejtën e saj për pushim pa pagesë.
14. Parashtruesja e kërkesës, me padinë e paraqitur në Gjykatën Komunale në Prizren, kërkoi që të anulohen si të paligjshme Vendimi i Komisionit disiplinor i Shtëpisë së Shëndetit në Prizren, nr. 13/15, të 23 janarit 2001, dhe Vendimi i drejtorit, nr. 3/61, i 27 nëntorit 2001.
15. Më 24 maj 2005, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 64/2005, e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, me të cilën kërkoi që të kthehet në vendin e punës specialist i fiziatriisë, që t'i kompensohen të ardhurat personale që nuk i janë paguar si dhe t'i njihet dhe t'i lejohet pushimi pa pagesë.
16. Më 11 nëntor 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Gž. nr. 340/2005, e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e aprovoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 64/2005, të 24 majit 2005.
17. Më 21 qershor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 15/2006, e refuzoi revizionin e parashtrueses së kërkesës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gž. nr. 340/2005, të 11 nëntorit 2005.
18. Më 5 qershor 2009, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim për përsëritjen e procedurës pranë Zyrës së EULEX-it në Prizren.
19. Më 22 shkurt 2010, gjyqtari i EULEX-it, në përgjigje Ref. JC/EJU/PrzDC/o61/vk/09, e njoftoi parashtruesen e kërkesës si më poshtë:
“... dëshirojmë të theksojmë se gjyqtarët e EULEX-it, janë kompetent për rastet të cilat ende nuk janë vendosur nga gjykatat në Kosovë. Me keqardhje, çështja juaj nuk hynë në këtë juridiksion sepse ajo është përfunduar me dt. 21.06.2006. Andaj, gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prizren nuk do të ndër marrin kurrfarë veprimi.”
20. Më 6 mars 2012, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Komunale në Prizren.

21. Më 3 korrik 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin P. nr. 64/2005, e hodhi poshtë propozimin për përsëritjen e procedurës kontestimore të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë, P. nr. 64/2005.
22. Më 16 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë, me të cilën ka kërkuar që Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 64/2005, i 3 korrikut 2012, të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në përsëritje të procedurës.
23. Më 31 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ca. nr. 3875/2012, e hodhi poshtë propozimin e parashtrueses së kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar në Gjykatën Komunale në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 64/2005, të 24 majit 2005, i cili e mori formën e prerë prej 11 nëntorit 2005, me arsyetimin e mëposhtëm:

“Nga informacionet e EULEX-it, (Referenca e dt. 22 .02.2010) rezulton se gjyqtarët e EULEX-it, e kanë informuar paditësen se çështja e ngritur nga ajo në bazë të propozimit për përsëritjen e procedurës nuk është kompetencë e Gjykatës së EULEX-it, dhe se në këtë drejtim ajo nuk do të ndërmerri kurrfarë veprimi.”

“Me nenin 234.3 të LPK-së, është përcaktuar: "Pas kalimit të afatit prej 5 vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet ... ". Në rastin konkret propozimi për përsëritjen e procedurës i referohet gjetjes së fakteve dhe provave të reja (dëgjimit të dëshmitares) e që përfaqësojnë bazë për përsëritjen e procedurës konform nenit 232 g) të LPK, Kolegji vlerëson se propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitur nga pala paditëse është jashtë afatit ligjor sepse nga data 11.11.2005 kur aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.64/2005 është bërë i formës së prerë e deri me dt. 06.03.2012 kur paditësja e ka paraqitur propozimin në gjykatën komunale në Prizren, kanë kaluar më tepër se 5 vite.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e Kosovës gabimisht i ka llogaritur afatet në lidhje me datën kur e ka parashtruar kërkesën për përsëritjen e procedurës. Parashtruesja e kërkesës konsideron që si datë e aplikueshme është dashur të merret data kur ajo e ka parashtruar kërkesën në Zyrën e gjyqtarit të EULEX-it në Prishtinë, dhe thekson si në vijim:

“...kështu që isha e bindur se propozimi për përsëritjen e procedurës do t'i dërgohet Gjykatës Komunale të Prizrenit, gjë që nuk u bë, duke u shkelur kështu Kushtetuta dhe ligji“.

“Prandaj është e pabazuar pikëpamja e Gjykatës së Apelit se propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur pas skadimit të afatit prej 5 vjetësh nga dita kur aktgjykimi kishte marrë formë të prerë, duke përmendur datën 06.3.2012, edhe pse është fakt i pamohueshëm se në datën 19.2.2009 kam paraqitur propozim për përsëritje të procedurës, pasi kisha marrë vesh se mjekëve të tjerë të Shtëpisë së Shëndetit të Prizrenit u ishte

mundësuar si mungesa me pagesë, ashtu edhe mungesa pa pagesë, pra, në rastin konkret nuk kishte kaluar afati prej 5 vjetësh“.

25. Në bazë të asaj që u tha në këtë kërkesë, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese si më poshtë:

“Mua më është mohuar e drejta për punë, e cila garantohet me Kushtetutë. Gjithë këto vite bëjë pyetjen se si është e mundur që për shkak të përsosjes profesionale më bëhet e pamundur të punoj, prandaj ju drejtohem Juve me këtë propozim – që të konstatooni se propozimi për përsëritje të procedurës është parashtruar brenda afatit dhe që aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me ligjin dhe me konventat ndërkombëtare.“

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me lig”.

28. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“

29. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se ...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese “.

30. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me mënyrën e gabuar të llogaritjes së afateve nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga ana e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ 1999-I).

31. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë, Ca. nr. 3875/2014, i 31 janarit 2014, në arsyetimin e tij në detaje shpjegon arsyet e refuzimit të kërkesës për përsëritjen e procedurës dhe jep përgjigje në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me afatet ligjore.
32. Gjykata Kushtetuese thekson që parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese. (shih, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
33. Në këtë rast, parashtrueses së kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e saj dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron së është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Prizren, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe para Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në ndonjë mënyrë, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
34. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë pretendimet se me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese.
35. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.
36. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për moszbulimin e identitetit të saj, Gjykata e refuzon atë si të pabazuar, sepse nuk është ofruar asnjë dokument dhe informacion që do të mbështeste arsyet për moszbulimin e identitetit të parashtrueses së kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për moszbulimin e identitetit së saj;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. paragrafi 4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Krjetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani